



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, 06 janar 2011

NJOFTIM

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, (Nr. 03/L-121), si dhe në zbatim të hapit 2a të Udhëzimit Administrativ Nr. 2003/01 mbi Procedurat e Rekrutimit, përkatësisht për shkak të mos arritjes së numrit të balancuar të kandidatëve, sipas përfaqësimit etnik, gjegjësisht përfshirjes së ultë të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë, Sekretaria e Gjykatës Kushtetuese njofton të gjithë aplikuesit për rishpalljen, përkatësisht zgjatjen e afatit të konkurrimit edhe për pesëmbëdhjetë (15) ditë të tjera për vendet e punës, të shpallur më dt.26 nëntor 2010 , në të përditshmet ditore , në ueb faqen e Gjykatës Kushtetuese si dhe të emituar në Radio Graçanica:

1. Përkthyes nga shqipja në anglisht e serbisht dhe anasjelltas (2)
2. Administrator i Sistemit(1);
3. Zyrtar për Marrëdhënie me Publikun (Zëdhënës 1) dhe
4. Zyrtar për protokoll (1);

Gjykata Kushtetuese inkurajon veçanërisht pjesëtarët e Komuniteteve jo shumicë në Republikën e Kosovës që të aplikojnë për pozitën e shpallura përmes Konkursit të ri.

Njëkohësisht, njoftohen të gjithë kandidatët, të cilët kanë aplikuar për këto vende pune në konkursin e mëparshëm, i cili edhe më tutje vazhdonë të mbetet i publikuar në ueb faqen e Gjykatës Kushtetuese, se aplikacionet e tyre do të merren parasysh dhe se nuk kane nevojë për aplikim të sërishëm, ndërsa konkursi mbetet i hapur deri më datën 22.01.2011, ne ora 24.00.